



Kryetari i Komunës

01-Nr. 464-10635

Me datë: 04-03-2026.

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr-03/L-040; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031; nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008; në bazë të nenit 4, nenit 10 Ligji Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluejtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligji Nr.03/L-205; bazuar në Vendimin me nr. prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 për pranimin formal të kërkesës për shpronësim, pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve, Brenda afatit ligjorë, Kryetari i Komunës së Suharekës, mere këtë:

VENDIM PRELIMINAR
(Mbi ligjshmerinë e shpronësimit të propozuar)

1.SHPRONESOHET prona private e pronarëve dhe zotruesve të interesit, për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, e cila gjendet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116043-01098-11, në sip. prej 8m², me kultur Arë E Klasës 2, në vendin e quajtur “RUPE/DRUM” e cila evidentohet sipas qertifikatës së pronës në emër të Hamit Adem Kryeziu, ZK. Sopijë.

2. VERTETOHET se zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës publike në ZK Suharekë është interes i përgjithshëm publik dhe se shpronësimi i paluejtshmëris së lartëcekur do të shërbej për lëvizjen e lire të qytetarëve, është qëllim i ligjshëm dhe në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

3. Vlera e kompenzimit të pronës së cekur në piken 1. të këtijë Vendimi, caktohet nga Ministria e Financave-Zyra e veçant për vlersimin e pronës së paluajtëshme, konform Ligjit për Shpronësimin e pronës së paluajtëshme Nr.03L-139 me ndryshim dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr-03/L-205 për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlersimit që do të përdorën për përlogaritjen e shumës së kompenzimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

4. Vendimin preliminar, Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t’ia dërgoj zotëruesve të interesit të pronës dhe personave të tjerë të cilët pretendojnë se ju takon ndonjë e drejtë në pronën e shpronësuar.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Preliminar, organi shpronësues e shpall vendimin në Gazetën zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Rep. Kosovës.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Departamenti për shpronësim në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër .



Ar sy e t i m

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës konstaton se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar si në dispozitiv të këtij Vendimi Preliminar është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtit qëllim dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtat private, se pjesa e pronës së palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qëshetje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij Ligji .

Organi shpronësues–Kryetari i Komunës me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim të paluajtshmërisë 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 ka miratuar kërkesën e subjektit kërkues-Drejtorisë për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pylltari të Komunës së Suharekës për shpronësimin e pronës së palujtshme për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqan”, zk Sopijë.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkues është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës për kundërshtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej: 15 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Preliminar. Në të njejtën ditë në të cilën parashtguesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtguesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtëpërdrejtë të dorëzojë në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për shpronësim).

Vendimi u dërgohet:
Subjektit kërkues
Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe
Arkivit

Kryetari i Komunës :
Bali Muharremaj

